



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 75, datë 13.04.2018

PËR

**MIRATIMIN E SHOQËRISË AUDITUESE, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE
FINANCIARE TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE, PËR VITIN
2017**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 16, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesioneve të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, me vendimin nr. 41, datë 26.02.2018 miratoi kriteret e përzgjedhjes të shoqërisë audituese, për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2017, të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Në zbatim të këtij vendimi, si dhe me qëllim mundësimin e marrjes së shërbimit “Për auditimin e pasqyrave financiare të AMF-së, për vitin 2017”, Sektori i Shërbimeve dhe Prokurimeve, procedoi me zbatimin e procedurave të prokurimit publik sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

Bazuar në nenin 29 pika 5 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në datë 16.03.2018 u zhvillua procedura e prokurimit me vlerë të vogël me fond limit 500,000 lekë pa Tvsh ose 600,000 me Tvsh, me objekt “Auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 të AMF-së”.

Në përfundim të përzgjedhjes në sistemin elektronik të APP, rezultoi fitues për ofrimin e shërbimit të kërkuar shoqëria audituese “Mazars” sh.p.k.

Pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar, rezulton se kjo shoqëri ka përmbushur kriteret e miratuara nga Bordi i AMF-së.

Përsa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shoqërisë audituese “Mazars” sh.p.k, për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2017, të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
2. Ngarkohet Departamenti i Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI